

Konferenca e I-rë Kombëtare
për
«Politikat Shëndetësore në Shqipëri»

Strategjia e OBSH për shëndetin deri në 2020
Shëndeti në të gjitha politikat

Hotel Tirana International
11 Maj 2012

FUQIZIMI I
SISTEMIT TË INFORMACIONIT
DHE KËRKIMIT SHKENCOR

EDUARD KAKARRIQI

Kornizë ligjore dhe historike: momentet kyç

- Ministria e Shëndetësisë (MSH), Instituti i Shëndetit Publik (ISHP), dhe Instituti i Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor (ISKSH) – furnizuesit e statistikave shëndetësore për Institutin e Statistikave (INSTAT) (Ligji “Për Statistikat”, 2004)
- ISHP – qendër e kërkimit shkencor, qendër reference e shërbimeve në fushën e shëndetit publik, qendër universitare dhe qendër informacioni (Ligji “Për Shëndetin Publik”, 2009)
- ISHP – Qendra Kombëtare e Sistemit të Integruar të Survejancës të Sëmundjeve Infektive (SISSI) (Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë, 1997)
- ISHP – Observatori Kombëtar Epidemiologjik dhe regjistrat kombëtarë të veçantë për realizimin e survejancës epidemiologjike të faktorëve risk dhe barrës së sëmundjeve (Ligji “Për Shëndetin Publik”, 2009)
- “Albania HIS Working Plan 2010-2015” (11.2.2009), në kuadër të Health Metrix Network (HMN) mbi programin e fuqizimit të sistemit të informacionit shëndetësor
- ISHP – Ngritja e Sistemit Data Warehouse për Modernizimin e Sistemit Shëndetësor (Urdhër i Ministrit të Shëndetësisë, 2011)
- SHP – Qendra e Sistemit Kombëtar të Informacionit për Drogën (VKM, 2011)
- Ligji “Për Mbrojtjen e Të Dhënave Personale”, 2008

Sistemi i Informacionit Shëndetësor (SISh)

Seti (takëmi) i komponentëve dhe procedurave të organizuara me objektiv gjenerimin e informacionit për përmirësimin e vendimeve të menaxhimit të kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.

Pra, SISh:

- ▶ Grumbullimi, kontrolli, interpretimi dhe analiza e statistikave shëndetësore
- ▶ Prodhimi i indikatorëve shëndetësorë
- ▶ Prodhimi në kohë i informacionit të vlefshëm, të besueshëm dhe të saktë për përdorim nga politikë-planizuesit dhe politikë-bërësit
- ▶ Për përdorimin e tij në përmirësimin e efektivitetit dhe eficiencës së shërbimeve shëndetësore nëpërmjet një menaxhimi sa më adekuat të tyre
- ▶ Për përmirësimin në vijueshmëri të gjendjes shëndetësore të popullatës si synim përfundimtar

Dimensionet e kërkesës për SISh

■ Determinantët e shëndetit

■ Inputet në sistemin shëndetësor dhe proceset e lidhura me të

(infrastruktura shëndetësore, burimet njerëzore dhe financiare, mjetet dhe pajisjet, menaxhimi, organizimi)

■ Performanca apo outputet e sistemit shëndetësor

■ Rezultatet shëndetësore

(vdekshmëria, sëmundshmëria, paaftësia, mirëqenia, gjendja shëndetësore)

■ Padrejtesitë dhe pabarazitë në determinantët/përcaktorët e shëndetit


(mbulesa me shërbime shëndetësore dhe përdorimi i tyre me shtresëzim sipas seksit, gjendjes social-ekonomike, grupeve etnike, shpërndarjes gjeografike urban/suburban/rural dhe zona të afërta/zona të thella malore)

Dimensionet e mbështetjes ndaj SISh


- **Mjetet dhe metodat e disponueshme për gjenerimin e informacionit shëndetësor**
 - **Gjenerimi i të dhënave lidhur me popullatën**
(censuset, të dhënat jetësore [zyrat e gjendjes civile],urvejimet ndërseksionale)
 - **Gjenerimi i të dhënave mbi operimin e shërbimeve shëndetësore**
(të dhënat administrative, të dhënat e shërbimit, kartelat individuale shëndetësore)

- **Survejanca** –
njëherësh burim i të dhënave, funksion dhe proces.


Transformimi i të dhënave në informacion dhe evidencë




Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»





Korniza e HMN



Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»

Nevojat dhe mjetet e informacionit në nivele të ndryshme të grumbullimit të të dhënave





Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»

Burimet e të dhënave të SISH

Censuset

Të dhënat mbi burimet

Regjistrat civilë

Të dhënat e shërbimit


Survejimet në popullatë

Të dhënat individuale


Bazuar-në-Popullatë

Bazuar-në-Institucion

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»




Standardet

- Censuset, e kryera si rregull çdo dhjetë vjet konform standardeve ndërkombëtare UNDESA, japin karakteristikat e gjithanëshme demografike, social-ekonomike, arsimore, kulturore, etj, të popullatës së vendit, në shkallë vendi, qarku, bashkie, komune
- Të dhënat e përfuara janë bazament në përfitim të indikatorëve të SISH

Elementet strategjike

- Censusi i vitit 2001 dhe projektimet vjetore 2002-2010 nga INSTAT të popullatës (shkallë vendi, qarku, rrethi, bashkie/komune)
- Censusi i vitit 2011: problemet lidhur me popullatën dhe ndikimi përkatës në prodhimin e indikatorëve shëndetësorë (=emëruesi)

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»




Standardet

- Performancë adekuate e Zyrave të Gjendjes Civile (nën- ose mbi-raportim i të dhënave)
- “Skeda e Lindjes” dhe “Skeda e Vdekjes”:
 - Lindjet dhe Ngjarjet Perinatale
 - Vdekjet (mosha, gjinia, shkaku)
- Të dhënat e përfuara janë bazament në përfitim të indikatorëve të SISh

Elementet strategjike

- Problemet e raportimit të lindjeve (jo në kohë, deri mosraportim)
- Problemet e raportimit të vdekjeve foshnjore
- Problemet e raportimit të vdekjeve sipas shkakësisë
- Përmirësimi i Skedave të Lindjes dhe Vdekjes

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»




Standardet

- Survejimet ndërseksionale në popullatë lidhur me statusin shëndetësor, determinantët risk mjedisorë dhe të sjelles, problemet e menaxhimit shëndetësor, problemet e aksesit në shërbimet shëndetësore, etj
- Të dhënat e përftuara janë bazament në përftimin e indikatorëve të SISh

Elementet strategjike

- Madhësia (=saktësia) dhe cilësia (=tejsaktësia) e zgjedhjes së përzgjedhur në popullatë
- Pyetësorët dhe intervistimet: problemi i biaseve
- Analiza e të dhënave dhe interpretimi i rezultateve: dilema “pula-veza” për shkakësinë

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»




Standardet

- “Kartela e Pacientit” në Shërbimin Spitalor: plotshmëria, saktësia, cilësia e të dhënave
- “Skeda Individuale e Pacientit” në Shërbimin Parësor: plotshmëria, saktësia, cilësia e të dhënave
- Të dhënat e përfthuara janë bazament në përfitim të indikatorëve të SISh

Elementet strategjike

- Përpilimi dhe implementimi i Udhëzuesëve Klinikë dhe Protokolleve Klinike të Standardizuara (shërbimi spitalor, shërbimi parësor)
- ISKSh në monitorimin dhe vlerësimin periodik
- QKCSAISH në kontrollin e cilësisë dhe sigurisë dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»




Standardet

- Indikatorët apo të dhënat e gjithanëshme të shërbimit të institucionit shëndetësor (spitalor, parësor): organizimi, planifikimi, menaxhimi, aktiviteti, funksionimi, efektiviteti, efizienzja (kosto-efektiviteti), përfitimi në shëndet
- Të dhënat e përftuara janë bazament në përftimin e indikatorëve të SISh

Elementet strategjike

- Plotshmëria, saktësia dhe cilësia e dokumentacionit të institucionit shëndetësor
- Database elektronike dhe ndërkëmbimi elektronik i të dhënave ndërmjet institucioneve
- Kodifikimi (= ID e pacientit) si metodë "capture-recapture" për eliminimin e dublikimeve

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



Standardet

- Burimet financiare dhe kostot
- Burimet njerëzore dhe shpërndarja adekuatë e tyre
- Mjetet, aparaturat, medikamentet, etj
- Të dhënat e përftuara janë bazament në përftimin e indikatorëve të SISh

Elementet strategjike

- Database elektronik për problemet financiare të institucionit shëndetësor
- Database elektronik për personelin e institucionit shëndetësor
- Edukimi në Vazhdim
- Aktiviteti studimor/kërkimor

**Sistemi (ligjor) i Integruar i Survejancës
të Sëmundjeve Infektive në Shqipëri – SSSI:**

**Sistemet përbërëse të tij
dhe
Udhë-ecuria e fluksit informativ**

SISSI (Sistemi i Integruar i Survejancës të Sëmundjeve Infektive)

SMBS (Sistemi Madhor i Bazuar-në-Sëmundje i Survejancës)


**ALERT (Sistemi i Bazuar-në-Sindroma) i Survejancës
[=Early Warning System]**

**Sistemet e Veçanta të Bazuara-në-Rast të Survejancës
(me Konfirmim Laboratorik)**

- Paralizat Flakside Akute
- Fruthi & Rubeola
- Sindromi i Rubeolës Kongjenitale
- Hepatitet Virale Akute
- Infeksionet invazive nga *Haemophilus influenzae b*
- Gripi A
- Infeksionet Seksualisht të Transmetueshme (IST)

Raportimi i Laboratorëve Mikrobiologjikë (të Shëndetit Publik & Privatë)

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



Të dhënat mbi Vdekshmërinë

INSTAT – burimi i të dhënave

ISHP – prodhuesi i indikatorëve përkatës:

- Nivelet Bruto dhe të Standardizuara Gjini-specifike dhe Moshë-specifike të Vdekshmërisë së Përgjithshme
- Nivelet Bruto dhe të Standardizuara Gjini-specifike dhe Moshë-specifike të Vdekshmërisë Shkak-specifike
- Nivelet Bruto dhe të Standardizuara Gjini-specifike dhe Moshë-specifike të Vdekshmërisë së Përgjithshme dhe Vdekshmërisë Shkak-specifike sipas ndarjes Urban/Rural dhe në shkallë Rrethi dhe Qarku

Sfida: Pamundësi e **ISHP** për prodhimin e indikatorëve të detajuar të vdekshmërisë (konform kërkesave të OBSH dhe Eurostat) nga mangësia e fluksit informativ përkatës të ofruar nga **INSTAT**

Zgjidhja: Akses i plotë i **ISHP** në database të **INSTAT** për Skedat e Vdekjes

Të dhënat mbi Sëmundshmërinë Spitalore

Udhë-ecuria e deritanishme e fluksit informativ:

Shërbimi Spitalor → **MSH** → **ISHP**

Udhë-ecuria e pritshme e fluksit informativ:

Shërbimi Spitalor → **MSH**
↓
ISHP (Observatori Epidemiologjik – Data Warehouse)



ISHP – prodhimi i indikatorëve përkatës:

- Nivelet Bruto dhe të Standardizuara të Sëmundshmërisë Gjini-specifike dhe Moshë-specifike të Përgjithshme dhe Shkak-specifike
- Nivelet e mësipërme sipas Rretheve dhe Qarqeve dhe sipas ndarjes Urban/Rural

Të dhënat mbi Sëmundshmërinë Ambulatore

Udhë-ecuria e deritanishme e fluksit informativ:

Shërbimi Ambulator → **ISKSH** → **ISHP**


Udhë-ecuria e pritshme e fluksit informativ:

Shërbimi Ambulator → **ISKSH**
↓
ISHP (Observatori Epidemiologjik – Data Warehouse)

ISHP – prodhimi i indikatorëve përkatës:

- Nivelet Bruto dhe të Standardizuara të Sëmundshmërisë Gjini-specifike dhe Moshë-specifike të Përgjithshme dhe Shkak-specifike
- Nivelet e mësipërme sipas Rretheve dhe Qarqeve dhe sipas ndarjes Urban/Rural

BIAS-et
NË SISTEMIN E RAPORTIMIT
NË SURVEJANCËN E SHËNDETIT PUBLIK



- Aftësia profesionale në venien e diagnozës:
= *bias në verifikimin e rastit*

Porse, moment krejtësisht subjektiv (bazuar në aftësinë individuale profesionale)

Rrjedhimisht, *nevoja e edukimit të vazhdueshëm*.

- Mangësitë krejtësisht objektive në etiketimin e diagnozës
(etiketimin e sëmundjes)
= përsëri *bias në verifikimin e rastit*

Porse, tanimë, për një arsye objektive:


- vijimi i përdorimit në vendin tone të ICD-9 me vetëm tre-karaktëre për secilin entitet nozologjik,
- madje, i një përkthimi që le për të dëshiruar,
- i pasqyruar në një libërth të viteve '1980,
- askurrë ndonjëherë i përditësuar.

- Mangësitë dhe të metat sasiore dhe cilësore në **Sistemin e Dokumentacionit të Pacientit**, që përfaqëson thelbësisht “zemrën” e Sistemit të Informacionit Spitalor

Sistemi i Dokumentacionit të Pacientit duhet të jetë (çka aktualisht vuan të jetë):

- i saktë (=eliminim i plotë i *bias*-eve të verifikimit të rastit dhe *bias*-eve të raportimit të rastit)
- i plotë në sasi
- i thjeshtë në paraqitje dhe manipulim
- i besueshëm në përmbajtje
- i kohës (bashkëkohor) në të dhëna
- fleksibël (i epshëm) ndaj ndryshimeve
- i verifikueshëm
- ekonomik (efiçient apo kosto-efektiv)
- dhe, sidomos, *i standardizuar*

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



ISHP: Informacioni Shëndetësor mbi Determinantët Risk Mjedisorë dhe Monitorimi i tyre

- 1. Monitorimi i Ujit të Pijshëm**
- 2. Monitorimi i Mbetjeve Urbane**
- 3. Monitorimi i Ajrit (Ndotja e Ajrit)**
- 4. Monitorimi i Zhurmave (=Ndotja Akustike Urbane)**
- 5. Monitorimi i Ndotjes së Ujrave Rekreative (=Plazhet)**
- 6. Monitorimi i Ndotjes së Tokës**
- 7. Siguria Ushqimore**
- 8. Siguria në Punë dhe Epidemiologjia Okupacionale**
- 9. Monitorimi i Pamjaftueshmërisë (Defiçencës) Jodike**
- 10. Epidemiologjia e Nutricionit**

ISHP: Informacioni mbi Shëndetin Riprodhues

- 1. Sëmundshmëria dhe Vdekshmëria Foshnjore**
- 2. Sëmundshmëria dhe Vdekshmëria Fëmijënore <5 vjeç**
- 3. Programi LMIS (Sistemi i Informacionit për Menaxhimin Logjistik të Shpërndarjes dhe Përdorimit të Kontraceptivëve)**
në kuadrin e **Shërbimit të Planifikimit Familjar**
- 4. Survejanca e Abortit**
- 5. Survejanca e Defekteve të Lindura**

ISHP: Informacioni mbi Determinantët Risk të Sjelljes

- 1. YRBS mbi Sjelljet Riskante në të Rinjtë**
- 2. Bio-BSS në popullatë dhe grupet në-risk-të-lartë**
- 3. ESPAD mbi alkoolin dhe drogat psikoaktive në të rinjtë e shkollave**
- 4. Studimet mbi Duhanin në të rinjtë dhe popullatën e përgjithshme**
- 5. Studimet mbi Alkoolin në të rinjtë dhe popullatën e përgjithshme**

ISHP: Survejimet mbi Sëmundjet Infektive [1]

□ Studime (=survejime ndër-seksionale) epidemiologjike mbi sëmundje të ndryshme infektive:

- Hulumtimet mbi mozaikun (ansamblin, tërësinë) e determinantëve risk
- Hulumtimet mbi hallkën e transmetimit, veçanërisht atij vektorial:
 - / studime në entomologjinë mjekësore
(përfthimi i hartës së habitateve/biotopeve/biocenozave të insekteve-vektorë në Shqipëri sipas tipizimit-lloj të tyre)
 - / studime në rodentologjinë mjekësore
(përfthimi i hartës së habitateve/biotopeve/biocenozave së brejtësve në Shqipëri sipas tipizimit-lloj të tyre)
- Hulumtimet laboratorike për agjentët mikrobikë:
 - bakterikë
 - viralë
 - parazitare e mykotikë


ISHP: Survejimet mbi Sëmundjet Infektive [2]

- Studime (=survejime ndër-seksionale) sero-epidemiologjike (serologjike) mbi sëmundje të ndryshme infektive:
 - Profilet serologjike të popullatës ndaj **hepatiteve virale A, B, C, D, E** dhe trendet përkatëse në ecurinë e kohës
 - Sero-epidemiologjia e **HIV/AIDS/IST**
 - Sero-epidemiologjia e **enteroviruseve**
 - Sero-epidemiologjia e **gripit**
 - Sero-epidemiologjia e **viruseve respiratore**
 - Sero-epidemiologjia e **infeksioneve virale me vatra natyrore**
 - Sero-epidemiologjia e **infeksioneve bakterike koksike (meningokoku, streptokoku β-hemolitik, etj)**
 - Sero-epidemiologjia e **klamidiazave**
 - Sero-survejimet epidemiologjike mbi **grupin ToRCHES**
 - etj.....

ISHP: Studime / Kërkime Epidemiologjike të tjera

- 1. Studimi (Survejimi) mbi Shëndetin Riprodhues në Shqipëri**
- 2. Studimi (Survejimi) Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri**
- 3. Studimi (Survejimi) mbi Kapacitetet dhe Mangësitë në Shërbimin Shëndetësor Parësor në Shqipëri**
- 4. Survejim Ndër-seksional dhe Studim Rast-Kontroll mbi Vdekshmërinë Foshnjore në Shqipëri**
- 5. Studimi (Survejimi) mbi Ushqyerjen dhe Obezitetin**
- 6. Survejime mbi Shëndetin Mendor**

Konferenca e I-rë Kombëtare për «Politikat Shëndetësore në Shqipëri»



FALEMINDERIT